



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-46079 dt. 21/10/ 2025

PROCESVERBAL

I mbledhjes së shtatë të rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit, mbajtur më 25.09.2025, e cila filloi në orën 10:00.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani dhe deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 29 anëtarë.

Në mbledhje morën pjesë: Kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri - Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Blerina Gashi (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Valentina Leku (PDK), Manushaqe Mulaku (PDK), Kosovare Halilaj- Karaxha (PDK), Sali Dvorani (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Egzona Terdevci (VV), Filloreta Bujupi (VV), Selman Qallapeku, Arbër Halilaj (GREEN), Egzon Qorri (LDK), Muhamet Kurtaj, Mirlinda Dvorani.

Munguan: Mergim Pirraku(DD), Labinot Halilaj (PDK), Milaim Hajdari (PDK), Florentina Elezi-Veliu.(VV).

Të pranishëm ishin edhe: Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, Arben Shala nënkryetar i Komunës së Drenasit dhe drejtor të drejtorive komunale.

Mbledhja do të këtë

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal i mbajtur më datën 30.07.2025;
2. Draft-buxheti i Komunës për vitin 2026 dhe projeksionet për vitet 2027-2028;
3. Raporti i progresit për implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2024;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, pasi prezantoi rendin e ditës, meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime, kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës, prezent ishin 28 anëtarë të Kuvendit, rendi i ditës kaloi në mënyrë unanime pa ndryshime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e parë të rendit të ditës: **1.**Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit, të dt. 30.07.2025. Pasi nuk pati vërejtje, diskutime apo sugjerime, kryesuesi hodhi në votim pikën e parë të rendit të ditës, e cila kaloi me vota unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën **2.**Draft-buxheti i Komunës për vitin 2026 dhe projeksionet për vitet 2027-2028.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, Komuna ka mbajtur nëntë (9) takime buxhetore, po ashtu edhe Komiteti për Politikë dhe Financa, ku janë marrë të gjitha kërkesat dhe janë implementu në draft - buxhet për vitin 2026 dhe projeksionet për vitet 2027-2028. Në mbledhje e kemi shtuar numrin e punëtorëve në çerdhe për katër (4) punëtorë për shkak të zvoglimit të numrit të asmblisteve. Ju ftoj ta votoni buxhetin nese doni me ndryshu diçka është në dorën e juaj, sepse ju votoni për buxhetin.

Egzona Terdevci, ne e kemi marr buxhetin po nuk e kemi marrë kornizën për projekte kapitale e kemi gjet në veb faqe të Komunës edhe pse është dashur të na përcillet në email si material. Si mundemi me e votu një buxhet ku projektet e njejta kapitale janë prej vitit 2022, kurr nuk janë përfundu d.m.th janë të përsëritura tek pjesa e infrastrukturës komplet.

Si mundesh me besu që një projekt që bëhet tani paska me u realizu kur këto projekte nuk janë realizu për katër vjet, po thuani se i keni marrë parasysh rekomandimet nuk është e vërtetë, sepse nuk merren aspak parasysh rekomandimet. Kam qenë pjesë e degjimeve buxhetore të qershorit nuk ka ndërru asgjë prej asaj që është prezantu në fillim. Kemi rastin e mbështetjes për çerdhe madje edhe publikisht në emisione keni thënë që është bërë mbështetja për çerdhe, për familjet me nëvoja të ulëta po ajo thirrje nuk është shpall kurr publikisht, prandaj ne si vetvendosje nuk mundemi me e mbështetë një buxhet të tillë, sepse nuk i paraqet as nevojat, as prioritetet për qytetarët e Drenasit.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, çdo kërkesë që ka ardhur gjatë shqyrtimit të buxhetit derisa e kemi draftu, ne e kemi në buxhet gjithmonë mbi bazën e shifrave të cilat na i ka leju Qeverija është në dorën e anëtarëve të Kuvendit me e votu apo me lënë pas zgjedhjeve.

Egzona Terdevci, nuk është e vërtetë që janë marrë rekomandimet, nëse lista e projekteve kapitale vjenë e njetë si në qershor si në shtator ku janë ato rekomandime. Harrova me e përmend vërejtjen që e kemi pas vazhdimisht për mbledhjen e projekteve, pra keni veç asfaltim këtu atje pa e cek në cilën lagje, kështu i mashtroni qytetarët por është hera e fundit që keni me i mashtru, se nuk keni me qenë ketu ma.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, qytetari vendos a jam unë a s'jam edhe vetëm atyre ju japi llogari, ju ftoj të votoni buxhetin për qytetarët e Drenasit.

Mehdin Salihu, të vetmin ndryshim që e keni bërë që katër vite që e keni qit një flet me të ilustruar hallall ju qoft shumë mirë e keni pasqyru, kam shumë vërejtje asnjë projekt nuk është realizu të njejtën gjë që 4 vite po e përsëritin as nuk ceket rruga as vendi, unë nuk jam për me e votu këtë buxhet pa e specifiku saktë ku kemi me investu.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ne kemi demosin një institucion kredibil i cili ka marrë pjesë me neve në hartim dhe na ka rekomandu se si të draftojm buxhetin, ju si asambleist nuk e keni sjell asnjë kërkesë ose email zyrtarë për me bërë ndonjë ndryshim.

Mehedin Salihu, unë nuk e di për cilat institucione ndërkombëtare je duke folë që jemi kundër tyre, nëse kemi arritë deri në atë shkallë shumë mirë po më vjen. Unë nuk po flas për institucione ndërkombëtare, por për rrugë të asfaltuara, sepse jeni mësuar me punu ka tri orë asfalt e pas tri ore me u kthyer me thënë jemi gabim. T'i spo e din çka po bëhet me drejtorinë tënd e pom qet të institucionet ndërkombetare që nuk kanë të bëjnë hiq me këtë temë, unë nuk jam i interesuar më bërë fushatë politike, është vendi ku duhet me bërë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, në orën 10:35, Kuvendi shkonë në pauzë për pesë minuta.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, në orën 10:40, vazhdojmë senacën, jemi të pika e dytë e rendit të ditës 2. Draft-buxheti i Komunës për vitin 2026 dhe projeksionet për vitet 2027-2028. Meqenëse nuk pati diskutime, kryesuesi hodhi në votim pikën e dytë të rendit të ditës, prezent ishin 27 anëtarë, më 22 vota për, 5 kundër, 0 abstenim, kaloi pika e dytë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e 3. Raporti i progresit për implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2024.


Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, raportet nuk votohen, vazhdojme me pikën e katërt të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e 4. Të ndryshme.


Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, kryesuesi e konisderoi mbledhjen të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në ora 10:50

Procesmbajtësja


Fakete Hoti

Lekturoi


Nikelinda Bujupi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Bekim Lestrani